REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 2023/0071
Datë/Datum. «ProtocolDate»
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

2023/0071

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani Anëtar si dhe Kimete Gashi Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Ardi SH.P.K" sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzuese anti Covid për stafin e MPB-se" me nr. të prokurimit: 214-21-6523-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Punëve të Brendshme, me datën 25.04.2023, mori këtë:

VENDIM

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ardi SH.P.K" sh.p.k me seli në Prishtinë e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 08.02.2023 (me numër protokolli 71/2023) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzuese anti Covid për stafin e MPB-se" me nr. të prokurimit: 214-21-6523-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Punëve të Brendshme.

2.Anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimitme titull: "Furnizim me material shpenzuese anti Covid për stafin e MPB-se" me nr. të prokurimit: 214-21-6523-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Punëve të Brendshme, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

4. Me qenë se ankesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ardi SH.P.K" sh.p.k me seli në Prishtinë klasifikohet e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.09.2021, MPB në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzuese anti Covid për stafin e MPB-se" me nr. të prokurimit: 214-21-6523-1-2-1. Më datë 12.11.2021 është publikuar Njoftimi për dhënie të kontratës.

OSHP ka pranuar për shqyrtim ankesën me numër 53/22 të cilën e ka trajtuar si të pasaaftshme.

Më datë 24.01.2023, Autoriteti Kontraktues MPB ka marrë Vendim – Njoftim për anulimin e

aktivitetit të prokurimit me numër 214-21-6523-1-2-1 të datës 24.01.2023 me titull "Furnizim me

material shpenzues anti Covid për stafin e MPB-së", të cilin vendim AK thotë se e ka bazuar në

vendimin e OSHP-së me nr. 681/21 të datës 25.07.2022.

Kundër këtij Vendimi në AK ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim OE ankues "Ardi SH.P.K" sh.p.k, të cilën kërkesë më datë 31.01.2023 e ka refuzuar AK.

I pakënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, OE "Ardi" shpk në sistemin elektronik me datën 08. 02. 2023, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 71/23 (nr. protokolli).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës, kontratë publike kornizë e llojit: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 95.000,00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 23.02.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE "Ardi" sh.p.k të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit i datës 24 janar 2023 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Pretendimi Nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, ku pretendon se, vendimi të cilit i referohet AK për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me numër 681/21, i datës, 25.07.2022, nuk ka të bëjë fare me këtë aktivitet të prokurimit. I njëjti ka të bëjë me një aktivitet krejt tjetër të prokurimit dhe për më tepër AK nuk ka dhënë fare arsye pse duhet të anulohet por vetëm ka theksuar se në bazë të vendimit të OSHP-së, e anulon këtë aktivitet të prokurimit. Për më tepër kjo lëndë 681/21, është në "proces" në OSHP, dhe nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit.

Më tutje, OE ankues sqaron se, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP. Kjo e fundit duke vepruar sipas ankesës ka marrë aktvendim PSH.NR.53 2022, të datës 10.08.2022, me të cilin e ka hedhur poshtë si jashtë afatit për shqyrtim këtë ankesë, me arsyetimin se OSHP një kohë nuk ka pasur bord për shqyrtim të ankesave dhe tani kur bordi ekziston ka kaluar afati ligjor për të vendosur për këtë ankesë.

OE " Ardi" shpk, kundër këtij vendimi ka parashtruar Padi për propozim për shtyrje të aktit administrativ, në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje administrative. Kjo e fundit ka marrë aktvendim me të cilin e ka aprovuar kërkesën për shtyrje të aktit administrativ të OE "Ardi" shpk, dhe ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të OSHP-së, PSH.NR.53/2022, të datës 10.08.2022.

Rrjedhimisht, duke qenë se ekziston një vendim gjyqësor që ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të OSHP-së, për këtë aktivitet të prokurimit Psh.nr. 53/2022, AK Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka të drejtë të anuloj këtë aktivitet të prokurimit.

Më tutje, AK ka theksuar se një dispozitë e Ligjit kërkon anulimin. Mirëpo nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore se në bazë të cilit ligj e anulon këtë aktivitet të prokurimit.

Të gjitha këto argumente i kemi prezantuar me Kërkesën për Rishqyrtim, mirëpo AK nuk i ka trajtuar fare me arsyetimin se LPP nuk parasheh shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim. Ky konstatim i AK bie ndesh së pari me vendimin e lartë cekur të Gjykatës dhe së dyti me vet vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, ku AK me atë vendim, në faqen e fundit ka dhënë këshillën juridike duke na dhënë mundësinë që të parashtrojmë ankesë. Ne këtë të drejtë ligjore dhe sipas këshillës juridike e kemi shfrytëzuar dhe kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim, ndërsa tani AK MPB thekson se nuk po u shqyrtojkan në këtë fazë kërkesat.

Nuk është i saktë konstatimi i AK MPB se nuk ka dispozita ligjore që rregullojnë të drejtën për kërkesën për rishqyrtim/ankesë në këtë procedurë. Ky konstatim i AK bie ndesh me dispozitën e nenit 109 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se në çdo fazë të aktiviteteve të prokurimit mund të parashtrohet ankesë citojmë:

Neni 109 Afatet për dorëzimin e ankesës 1. Ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktiviteteve ose procedurave të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të Autoritetit Kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji".

Për me tepë, pas hapjes së tenderëve nuk lejohet që pa bazë ligjore të anulohet një aktivitet i prokurimit.

Si përfundim OE "Ardi" shpk, i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që në prani të këtyre argumenteve dhe provave të bashkangjitura të marr vendim aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e OE " Ardi" shpk, anulohen në tërësi njoftimi për kërkesën për rishqyrtim dhe njoftimi mbi vendimin e AK - njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 24.01.2023, ashtu që ky aktivitet i prokurimit kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te AK Ministria e Punëve të Brendshme.

Përgjigjet e Ekspertit shqyrtues në pretendimin nr.1

Eksperti shqyrtues konstaton se duke u bazuar në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 24.01.2023, ky aktivitet i prokurimit është anuluar me arsyetimin " se një dispozitë në Ligjin e prokurimit publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit", ndërsa tek pjesa V.2) Informacionet shtesë, Autoriteti Kontraktues si arsye shtesë ka theksuar se e anulon këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin "duke u bazuar ne vendimin e OSHP-se me nr. 681/21, të datës 25.07.2022".

Lidhur me ketë Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues është i bazuar, pasi që arsyetimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit në këtë fazë nuk është në pajtim me dispozitën nga neni 62, të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 44 pika 5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP).

Për më tepër, Eksperti shqyrtues konstaton se arsyetimi shtesë i dhënë tek pjesa V.2 tek informacionet shtesë në kuadër të njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit ku thuhet se "AK duke u bazuar ne vendimin e OSHP-së me nr. 681 21, të datës 25.07.2022, anulon këtë aktivitet të prokurimit nuk ka të bëjë fare me ketë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues konstaton se duke u bazuar në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimitnë pikën V.1 është dhënë këshilla juridike ku sipas saj " Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I të këtij Njoftimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit".

Eksperti shqyrtues konstaton se edhe përkundër se Autoriteti Kontraktues ka dhënë mundësinë sikurse është përcaktuar në kuadër të këshillës juridike të njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Megjithatë nuk e ka trajtuar në mënyrë meritore kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. Po ashtu në njoftimin e datës 31.01.2023, të Autoritetit Kontraktues rreth kërkesës për rishqyrtim thekson se LPP nuk parasheh trajtimin e kërkesave për rishqyrtim të OE-ve, në këtë fazë, prandaj e njofton palën ankuese që ti referohet vendimit të OSHP-së, me numër 53/22, të datës 10.08.2022, tek paragrafi këshilla juridike.

Lidhur me këtë Eksperti shqyrtues vëren se OE " Ardi" shpk, kundër këtij vendimi ka parashtruar padi për propozim për shtyrje të aktit administrativ, në Gjykatën Komerciale - dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje administrative. Kjo e fundit ka marrë aktvendim me numër të lëndës KA.nr. 1327/22, të datës 14.11.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesën për shtyrje të aktit administrativ të OE "Ardi" shpk, dhe ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të OSHP-së, Psh.nr.53/2022, të datës 10.08.2022, deri sa të merret vendimi përfundimtar lidhur me padinë e paditësit "Ardi" shpk.

Prandaj, Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108A të LPP-së, si dhe me aktvendimin KA.nr.1327/22, të datës 14.11.2022, të Gjykatës Komerciale - dhomat e shkallës së parë - Departamenti për Çështje administrative. Kjo për faktin se duke u bazuar në vendimin e Gjykatës i njëjti e ka shtyrë zbatimin e vendimit të OSHP-së, PSH.NR.53/2022, të datës 10.08.2022. Andaj, për deri sa nuk ka ndonjë vendim tjetër të Gjykatës lidhur me padinë e paditësit në këtë rast ankuesit "ARDI" shpk, Autoriteti Kontraktues nuk mund të thirret në vendimin e OSHP-së të cekur më lartë, pasi që i njëjti nuk është i zbatueshëm përkatësisht është shtyrë zbatimi i tij.

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, përfundimi aktivitetit të prokurimit bëhet për arsyet si më poshtë:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Ndërsa bazuar në nenin 44 pika 5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(i) asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

(iii) (numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3);

(iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(v) (numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;

(vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

(x) nëse AK gjate përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose

(xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Ndërsa duke u bazuar në Nenin 108/A të LPP-së, parashihet zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve citoj: 1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

Prandaj duke i pasur parasysh faktet dhe dispozitat ligjore si më lartë Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 1,7,62, dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë,

diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesiesi I Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
1x1 OE - **Ardi SH.P.K.**
1 x 1 Arkivës së OSHP-së:

1 x 1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së